



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202101495/2

Tiranë ___/___/2021

Lënda : *Rekomandim për inspektimin e kryer në Qendrën Provizore të Pritjes së migrantëve të parregullt në Kapshticë, Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin (DVKM), Korçë.*

Drejtuar : **Drejtues i Lartë Eduart MERKAJ**
Drejtor i Departamentit për Kufirin dhe Migracionin
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

TIRANË

Drejtues i Parë Fatmir HOXHA
Drejtor i DVKM-së Korçë

KORCË

Për dijëni: **Ministrisë së Brendshme**
Sekretarit të Përgjithshëm

TIRANË

Të nderuar zotërinj,

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në Qendrën Provizore të pritjes dhe akomodimit të emigrantëve të parregullt në Kapshticë, në varësi të Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin, Korçë.

Inspektimi u krye në datë 11.11.2021, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Grupi i inspektimit përbëhej nga z.Besnik Deda, znj.Nertila Qafëzezi, znj.Gloria Çarkaxhiu dhe z.Hazbi Selita, me detyrë nd/komisioner pranë Mekanizmit Kombëtar.

Qëllimi i inspektimit ishte vlerësimi i kushteve në Qendrën Provizore të pritjes së migrantëve të parregullt në Kapshticë, në varësi të DVKM Korçë, si dhe respektimin e të

drejtave dhe trajtimin e tyre, sipas dispozitave ligjore të parashikuara në legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar, për këtë qëllim.

Qendra Provizore e pritjes së migrantëve të parregullt, ndodhej në afërsi të Stacionit të policisë kufitare në Kapshticë. Kjo pikë kufitare bashkë dhe me pikën kufitare në Kakavijë, shërbejnë për të lidhur jugun dhe juglindjen e Shqipërisë me veriperëndimin e Greqisë, aty ku dhe janë ngritur dhe vendqëndrimet e emigrantëve që hyjnë në shtetin grek në mënyrë të parregullt. Këto pika kufitare, konsiderohen nga grupet e emigrantëve të parregullt, si portat më të mundshme për të depërtuar në territorin e vendit tonë.

Nga informacioni i marrë rezulton se, grupet migratore pasi mbërrijnë në Shqipëri, një pjesë shumë e vogël e tyre kërkojnë azil. Pjesa tjetër përmes pikave kufitare tokësore në veri të vendit vazhdojnë rrugëtimin drejt Kosovës apo Malit të Zi, me synimin për të shkuar në vendet e BE-së.

Rritja e flukseve migratore në periudha të caktuara vitet e fundit, ka sjellë për rrjedhojë mbipopullim në Qendrat provizore të pritjes së emigrantëve të ngritura në pikat e kalimit të kufirit në Kapshticë dhe Kakavijë, por edhe në Qendrën Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit Babrru dhe Qendrën e Mbyllur për të Huajt Kareç.

Referuar statistikave të hyrjes së emigrantëve të parregullt në pikën e kalimit të kufirit në Kapshticë, krahas procedurave të përzgjedhjes që ndjekin punonjësit e policisë në ambientin e intervistimit, bie në sy fakti se, kërkesat për azil për vitin 2021 kanë ardhur në rënie krahasuar me vitet e kaluara.

Konkretisht, **për vitin 2020**, kanë hyrë në territorin e Shqipërisë në pikën e kalimit të kufirit Kapshticë **15 534 emigrantë të parregullt**, nga të cilët 6062 përsëritësa dhe 9472 kanë hyrë për herë të parë. Nga këta të fundit, 1589 migrantë kanë qenë fëmijë nën moshëm 18 vjeç (1085 meshkuj dhe 513 femra) dhe 873 femra. Referuar intervistave të përzgjedhjes, **kanë aplikuar me kërkesa për azil në RSH 1404 persona**, janë plotësuar urdhërat për largim nga territori i vendit tonë për 8048 persona. Rezulton se 1 migrant është dërguar në QMH Kareç dhe 19 migrantë janë sistemuar në Qendrat sociale në Korçë dhe Tiranë.

Ndërkohë, **për vitin 2021** kanë hyrë në pikën e kalimit të kufirit Kapshticë **13 228 migrantë të parregullt**, nga të cilët 6628 përsëritësa dhe 6600 migrantë kanë hyrë për herë të parë. Nga këta të fundit, 1105 migrantë kanë qenë fëmijë nën moshën 18 vjeç (786 meshkuj dhe 319 femra) dhe 443 femra. Referuar intervistave të përzgjedhjes, **kanë aplikuar me kërkesa për azil vetëm 14 migrantë**, janë plotësuar urdhërat e largimit për 6582 persona. Rezulton se 1 migrant është dërguar në QMH Kareç dhe 7 migrantë janë akomoduar në Qendrat sociale në Korçë dhe Tiranë.

Legjislacioni vendas dhe ai ndërkombëtar

Nisur nga statistikat që tregojnë rënien e numrit të kërkesave për azil nga shtetasit e huaj, Avokati i Popullit sjell në vëmendjen e strukturave përgjegjëse për çështjet e azilit dhe

refugjatët se, kërkesa e këtyre shtetasve dhe anëtarëve të familjes së tyre për mbrojtje ndërkombëtare në territorin e Republikës së Shqipërisë, është një e drejtë e ligjshme dhe që garantohet nga konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë. Në mënyrë të veçantë parashikohet mbrojtja e posaçme për gratë dhe fëmijët.

E drejta për të kërkuar dhe përfituar azil është e ngulitur thellë në sistemin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut e vitit 1948, në Nenin 14.1 thuhet shprehimisht se: *“Çdokush ka të drejtë të kërkojë dhe gëzojë në vende të tjera azil nga përndjekja”*.

Më tej, njohja e statusit të refugjatit nga shtetet mori formën e traktatit nëpërmjet “Konventës së Gjenevës” e Kombeve të Bashkuara, që njihet si Konventa për Statusin e Refugjatit, e datës 28 korrik 1951, e ndryshuar me protokollin e Nju Jorkut, të datës 31 janar 1967, e ratifikuar. Këtë të drejtë e gëzojnë refugjatët të cilët përkufizohen në Nenin 1 të Konventës si *“[një] person që, për shkak të frikës së bazuar të persekutimit, për arsye të racës, fesë, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror apo bindjes politike, ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së vet dhe nuk ka mundësi, ose për shkak të një frike të tillë, nuk ka dëshirë të kërkojë mbrojtjen e atij vendi; ose kur ai, duke mos pasur shtetësi dhe ndodhet jashtë vendit të mëparshëm të banimit të zakonshëm të tij, si pasojë e këtyre ngjarjeve, nuk ka mundësi ose nuk ka dëshirë të kthehet atje, për arsye të kësaj frike.”*

Mbrojtja më e rëndësishme që merr një refugjat është, së pari, moskthimi në vendin e vet, ku është objekt i persekutimit. (kthimi – ndalohet nga Neni 33 i kësaj Konvente). Ka disa dispozita për përfundimin e statusit apo përjashtimin të cilat nënkuptojnë se, disa njerëz megjithëse janë në përputhje me përkufizimin e refugjatit, mund ta humbasin statusin e refugjatit apo mund të përjashtohen nga mbrojtja për shkaqe që parashikohen në Nenin 1 C-F të Konventës për Refugjatët.

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Torturës e vitit 1984 e zgjeron më tej detyrimin për moskthim duke përfshirë çdo person i cili rrezikon t’i nënshtrohet torturës. Neni 3.1 i saj përcakton: *“[asnjë] Shtet Palë nuk dëbon, kthen, (‘refouler’) apo ekstradon një person tek një shtet tjetër kur ka arsye thelbësore për të besuar se ai rrezikon t’i nënshtrohet torturës”*. Ky ndalim është absolut dhe nuk pranon asnjë përjashtim. Siç vihet re edhe në përkufizimet për refugjatin dhe përfituesin e mbrojtjes nga tortura, njohja e refugjatit, si i tillë, mund të bëhet vetëm kur aplikanti është jashtë vendit të tij të origjinës. Për sa kohë që aplikanti është ende në vendin e tij të origjinës apo të banimit të zakonshëm, atëherë, sipas Konventës së Kombeve të Bashkuara për Refugjatët, ai nuk mund të njihet si refugjat.

Në të njëjtën mënyrë, një person i cili ka frikë se do t’i nënshtrohet torturës, nuk mund të marrë mbrojtje ndërkombëtare nëse është ende në vendin e tij të origjinës ose të vendbanimit të zakonshëm. Personi duhet të ketë kaluar një kufi ndërkombëtar dhe të ketë

arritur në një vend tjetër me qëllim që të përfitojë azil dhe mbrojtje nga kthimi në vendin e tij.

E drejta për të kërkuar dhe përfituar azil gjendet e mishëruar edhe në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut dhe Kartën e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, **megjithatë ajo ende nuk është bërë e drejtë që merret në shqyrtim nga gjykatat**. Pra, ekziston një hendek mes individit i cili përpiqet të shpëtojë nga persekutimi apo tortura dhe detyrimit të shteteve nënshkruese të Konventës për Refugjatët dhe Konventës kundër Torturës për të mos i kthyer ata. Një nga shqetësimet e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët është se shumë vende, në Evropë dhe gjetkë, po shfrytëzojnë këtë boshllëk me qëllim shmangien e detyrimeve të tyre për të dhënë mbrojtje. Për sa kohë që janë ndërmarrë masat për të parandaluar largimin e njerëzve nga vendi i tyre i origjinës ose mbërritjen e tyre në vendin e destinacionit dhe kërkimin e azilit, atëherë në sytë e këtyre shteteve refugjatët nuk “ekzistojnë ” ose nuk janë përgjegjësi e shtetit që ka vendosur masat.

Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës duhet të sigurojnë respektimin e detyrimeve të tyre për të drejtat e njeriut, ashtu siç parashikohen, veçanërisht, nga Konventa. E drejta e gjithkujt për t'u larguar nga çdo vend, përfshirë edhe vendin e vet, është një e drejtë njerëzore e cila është e nënkuptuar edhe në të drejtën për jetë private dhe familjare, e parashikuar në Nenin 8. Për më tepër, e drejta e gjithkujt për t'u larguar nga vendi i vet duhet të sigurohet në mënyrë të barabartë si për shtetasit, ashtu edhe për të huajt dhe nuk duhet t'i nënshtrohet kurrë ndërhyrjeve që motivohen nga diskriminimi racial.

Gjatë zbatimit të kontrolleve kufitare dhe atyre të imigracionit, të gjitha shtetet e Këshillit të Evropës midis tyre dhe vendi ynë, duhet të shqyrtojnë dhe rishqyrtojnë, si dhe të harmonizojnë plotësisht ligjet, politikat dhe praktikat me Konventën dhe jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, duke ndaluar me efekt të menjëhershëm, prapësimet të cilat i ndalojnë njerëzit që të largohen nga vendi i tyre i origjinës apo që të arrijnë në BE dhe që të ushtrojnë të drejtën e tyre për të kërkuar dhe gëzuar azil.

Progres Raportit i Komisionit Evropian për vitin 2020 për Shqipërinë, në Kapitullin 24, “*Drejtësia, Liri dhe Siguria*”, thuhet se: “*Në lidhje me migracionin, kuadri ligjor për migracionin është në përputhje në pjesën më të madhe me acquis të BE -së, por ka nevojë të përditësohet në përputhje me zhvillimet e fundit*”.¹

Përsa citohet në Progres Raport, shteti shqiptar ka miratuar gjatë vitit 2020-2021 paketën ligjore ku përfshihet ligji nr.113/2020 “*Për Shtetësin*”, ligji nr.13/2020 “*Për disa*

¹ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2020-10/albania_report_2020.pdf

ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 108/2013, “Për të huajt”², i ndryshuar, si dhe ligjin nr.10/2021 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”³.

Sikurse theksuam edhe më lart, në vlerësimin e Institucionit të Avokatit të Popullit duhet të përshpejtohet puna për të bërë të mundur nxjerrjen sa më parë të akteve nënligjore, pasi janë tejkaluara edhe afatet kohore që këto ligje përcaktojnë.

Konkretisht, referuar ligjit “Për të Huajt” përcaktohet shprehimisht se: *“Këshilli i Ministrave, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore për të përcaktuar kriteret, procedurat dhe dokumentacionin për pajisjen me vizë elektronike, në zbatim të nenit 22, pika 5, dhe për formatin e aplikimit për vizën elektronike, në zbatim të nenit 24, pika 1, të ligjit”.*

Po ashtu, në ligjin “Për Azilin” thuhet shprehimisht se: *“Këshilli i Ministrave, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 1 të nenit 10, pikës 5 të nenit 34, të pikës 2 të nenit 44, të pikës 2 të nenit 56 dhe të pikës 3 të nenit 78 të këtij ligji”.*

Miratimi sa më parë i VKM-ve, do ti hapte rrugë edhe miratimit të akteve të tjera nënligjore si udhëzime dhe urdhëra nga ministritë e tjera përgjegjëse, që legjislativi ka ngarkuar për zbatimin e tyre.

Gjithashtu, plotësimi sa më parë i kuadrit të plotë logjor dhe nënligjor, do të rriste përgjegjësinë dhe do të bënte më efektive punën e strukturave shtetërore të krijuara për këtë qëllim, për marrjen në shqyrtim dhe miratimit në kohë sa më të shkurtër të kërkesave

² Ky ligj është përafshuar pjesërisht me Direktivën 2004/38/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 29 prill 2004, “Mbi të drejtën e shtetasve të Bashkimit Europian dhe të anëtarëve të familjeve të tyre për të lëvizur dhe qëndruar lirish brenda territorit të Shteteve Anëtare”, që ndryshon Rregulloren (KEE) dhe shfuqizon Direktivat 64/221/KEE, 68/360/KEE, 72/194/KEE, 73/148/KEE, 75/34/KEE, 75/35/KEE, 90/364/KEE, 90/365/KEE dhe 93/96/KEE, të ndryshuar. Numri CELEX 32004L0038, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 158, datë 30.4.2004, faqe 77-123.

³ Ky ligj është përafshuar pjesërisht me:

- Direktivën e Këshillit 2001/55/KE, datë 20 korrik 2001 “Mbi standardet minimale për dhënien e mbrojtjes së përkohshme në rastet e flukseve masive të personave të shpërngulur dhe mbi masat që promovojnë një ekuilibër përpjekjesh ndërmjet Shteteve Anëtare në pritjen e këtyre personave dhe përbalimin e pasojave”. Numri CELEX 32001L0055, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 212, datë 7.8.2001, fq. 12-23.

- Direktivën e Këshillit 2003/86/KE, datë 22 shtator 2003 “Mbi të drejtën e bashkimit familjar”. Numri CELEX 32003L0086, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 251, datë 3.10.2003, fq. 12-18.

- Direktivën 2011/95/BE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 13 dhjetor 2011 “Mbi standardet për kualifikimin e shtetasve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi si përfutues të mbrojtjes ndërkombëtare, për një status uniform për refugjatët ose për personat që kanë të drejtë për mbrojtje plotësuese, dhe për përmbajtjen e mbrojtjes së dhënë”. Numri CELEX 32011L0095, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L nr. 337, datë 20.12.2011, fq. 9-26.

- Direktivën 2013/32/BE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 26 qershor 2013 “Mbi procedurat e zakonshme për dhënien dhe tërheqjen e mbrojtjes ndërkombëtare”. Numri CELEX 32013L0032, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr.180, datë 29.6.2013, fq. 60-95.

- Direktivën 2013/33/BE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 26 qershor 2013 “Për përcaktimin e standardeve për pranimin e kërkuesve për mbrojtje ndërkombëtare”. Numri CELEX 32013L0033, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr.180, datë 29.6.2013, fq. 96-116.

të azilkërkuesve apo të të huajve me qëndrim të përhershëm apo të përkohshëm në Shqipëri.

Qendra e Pritjes së migrantëve Kapshticë

Qendra për Regjistrimin dhe Akomodimin e Përkohshëm të migrantëve të parregullt që hyjnë në Shqipëri në Kapshticë, është hapur dhe ka filluar të funksionojë në datë 29 Tetor të vitit 2019.

Qeveria shqiptare nëpërmjet autoriteteve dhe strukturave përgjegjëse që mbulojnë fushën e azilit dhe të refugjatëve, duke pasur në fokus respektimin e të drejtave të migrantëve në kuadër të mbrojtjes ndërkombëtare, në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) në Shqipëri dhe Bankën për Zhvillim e Këshillit të Evropës (CEBD) që mbështesin aksesin e migrantëve në strehim, kujdes mjekësor, higjienë dhe shërbime të tjera thelbësore të nevojshme, krijuan Qendrat për Regjistrimin dhe Akomodimin e Përkohshëm për migrantët e parregullt që hyjnë në Shqipëri.

Qendra në pikën e kalimit të kufirit në Kapshticë, u hap në kuadër të projektit *“Përmirësimi i kapaciteteve pritëse dhe aksesit në shërbime për migrantët dhe refugjatët që hyjnë në Shqipëri përmes Kapshticës, Korçë”*.

Kjo Qendër kishte në përbërje të saj 15 njësi akomodimi, një ambient intervistimi nga pala shqiptare dhe një ambient intervistimi nga ekspertët e FRONTEx, dhoma e mjekut dhe urgjencës, mjedisi për ngrënien e ushqimit, si dhe dy nyje hidrosanitare që shërbenin për tualete dhe dushe për larjen e trupit.

Kapaciteti i kësaj Qendre ishte për 60 persona. Njësitë për akomodimin kishin kapacitet për 4 persona në dhomë. Ato ishin të pajisur me 2 krevatë (marinari) për fjetje dhe ishin të kompletuara me dyshekë, batanije dhe jastek, si dhe tavolinë për ngrënie e stola për qëndrimin ulur. Çdo dhomë ishte e pajisur me kondicioner për ngrohje dhe ftohje. Pajisjet e hotelierisë siguroheshin nga CARITAS.

Në rastet kur në këto njësi, akomodohen familje mbi katër persona, kushtet në këto dhoma vështirësohen, por në çdo rast kjo bëhej me pëlqimin e vetë anëtarëve të familjes së emigrantëve.

Në momentin e inspektimit, në Qendër ndodheshin 78 migrantë, të cilët kishin kaluar në rrugë të parregullt kufirin dhe ishin konstatuar nga punonjësit e policisë të Komisarariatit të Policisë, Pogradec, duke udhëtuar në një kamion në drejtim të Tiranës. Grupi i inspektimit u informua se, krahas ndjekjes penale të autorëve të veprës penale, me grupin e migrantëve do të zhvilloheshin intervistat nga punonjësit e policisë kufitare në Qendër, duke zbatuar procedurat e përzgjedhjes së përcaktuar në ligj.

Koha e qëndrimit të migrantëve në Qendër ishte 24 orë. Më tej, secili prej migrantëve dërgoheshin në destinacionet e përcaktuara në përfundim të procedurave të përzgjedhjes ose pajiseshin me urdhër largimi, në të kundërt migrantët azilkërkues me automjetet e

policisë kufitare shoqëroheshin për në Qendrën Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit Babrru dhe Qendrën e Mbyllur për të Huajt Kareç. Fëmijët e pashoqëruar sistemoheshin në Qendrat sociale në Korçë dhe në Tiranë.

Sipas projektit me organizatat ndërkombëtare në bashkëpunim dhe me Bashkinë Ersekë, u ngrit Qendra për pritjen dhe akomodimin e fëmijëve migrant të pashoqëruar. Nga inspektimi në Qendër që zhvilloj grupi i monitorimit dhe takimi me N/kryetaren e Bashkisë Ersekë, rezultoi se, për arsye të mungesës të fondeve për investime dhe mungesës së stafit mbështetës, kjo Qendër aktualisht nuk po funksionon.

Në godinën e përcaktuar për këtë qëllim, kishte vetëm një dhomë me krevatë të dedikuar për fëmijët e pashoqëruar, ndërsa dhomat e tjera përdorreshin për destinacione të ndryshme në Bashkia Ersekë.

Gjithashtu, Bashkia kishte vetëm një punonjëse sociale që ishte e ngarkuar për menaxhimin e kësaj “Qendre” dhe mungonte gjithë infrastruktura mbështetëse nga strukturat e tjera shtetërore në nivel qendror. Gjithashtu, nuk kishte programe mbështetëse edhe nga donatorët. Sipas informacionit, vetëm në vitin 2019 ishin sistemuar gjithsej 4 fëmijë të pashoqëruar në këtë ambient dhe nga ajo kohë nuk ka patur asnjë fëmijë të shoqëruar nga Qendra e pritjes së migrantëve në Kapshticë.

Qendra në Kapshticë mbahej me fondet e IOM, ndërsa siguria realizohej nga policia kufitare e stacionit të policisë. Personeli ndihmës si përkthyesi, psikologu dhe mjeku, punonin me kohë të pjesëshme (me orare në varësi flukseve të migrantëve) dhe paguheshin nga fondi i CARITAS. Po nga ky fondacion, siguroheshin edhe ushqimi katering dhe veshmbathjet e ndryshme që i nevojiteshin migrantëve. Ngrohja dhe ftohja realizoheshin me kondicioner dhe furnizimi me ujë funksiononte 24 orë në ditë.

Stafi në stacionin e policisë kufitare në Kapshticë, kishte mungesa në organikë prej 16 personash, të cilat sipas informacionit të drejtuesve të policisë kufitare në Kapshticë dhe DVKM Korçë, mungesat në staf nuk ndikonin në ofrimin e shërbimeve dhe sigurinë e migrantëve në Qendrën e Përkohshme të pritjes së migrantëve. Stafi i policisë që shërbente në terren dhe ai që merrej për intervistimin e migrantëve të parregullt, ishin të trajnuar në seminare të organizuara nga OSBE, për mënyrën e trajtimit dhe mbi procedurën e intervistimit të tyre.

Nga referimi i ekspertit të Avokatit të Popullit, i cili monitoron rregullisht punën e punonjësve të policisë në pikën e kalimit të kufirit dhe Qendrën e pritjes së migrantëve të parregullt në Kapshticë, rezultoi se, procedurat e perzgjedhjes nuk kryhen rregullisht, pasi nga stafi nuk kryhen pyetjet e nevojshme për të bërë perzgjedhjen dhe identifikimin e migrantëve sipas kategorive, kryesisht të grupeve vulnerabël.

Për migrantët të cilëve ju plotësohet urdhëri i largimit, nuk zbatohet afati i qëndrimit në territor deri në 7(shtatë) ditë, me qëllim që ata të largohen në mënyrë vullnetare, por

punonjësit e policisë kufitare i shoqëronin ata me automjetet e tyre deri në pikën e kalimit të kufirit duke i larguar menjëherë.

Ndërsa për përsëritësa, të cilët kanë hyrë në territorin e vendit tonë më shumë se një herë, pyeten për gjeneralitet, ju merrnin shenjat e gishtave dhe i kthejnë menjëherë në kufirin e gjelbërt, pa marrë në konsideratë rastet në nevoje apo me familje.

Gjithashtu sipas informacionit, një nga arsytet e uljes të trendit të kërkesave për azil, ka të bëjë edhe me faktin se, migrantët gjatë intervistimit nuk pyeten rregullisht nga punonjësi i policisë kufitare nëse kërkojnë azil në Shqipëri apo jo. Kërkesat për azil plotësohet vetëm në rastet kur migrantët e kërkojnë me vullnetin dhe insistimin e tyre. Më tej, kjo kategori shoqërohet për në Qendrën e pritjes të migrantëve në Babrru, Tiranë, deri në pritjen të miratimit ose jo të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare, nga Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët.

Një problematikë që u evidentua nga inspektimi ishte, mungesa e përkthyesit për gjuhë të veçanta si Dari, Fars etj., e cila ka sjellë si pasojë dhe mungesën e komunikimit midis punonjësit të policisë kufitare dhe migrantëve që flasin këto gjuhë. Në këto raste, intervistimi kryhet në gjuhën angleze.

Dhoma e mjekut shfrytëzohej për vizitat rutinë dhe sa herë që ata kishin nevojë për raste të vizitave mjeksore më të specializuara ata dërgoheshin në spitalin e Bilishtit.

Ankesat/kërkesat e migrantëve shënoheshin në një libër të veçantë nga shefi i stacionit të policisë kufitare, Kapshticë, i cili ngarkonte dhe personin përgjegjës për zgjidhjen e tyre. Kryesisht, kërkesat e tyre kishin të bënin me takim me mjekun për vizitë mjeksore, si dhe për përkthyes në gjuhën e tyre.

Në zyrën e intervistimit si dhe në çdo njësi banimi kishte të afishuar postera me të drejtat e migrantëve në disa gjuhë të huaja si Anglisht dhe në gjuhën Arabe.

Përpunimi i mbetjeve përgjithësisht realizohej nga Bashkia e Devollit, por në rastet kur ka mbipopullime, është e nevojshme një menaxhim më efektiv nga ana e tyre, pasi nga grumbullimet për kohë të gjatë të mbetjeve, mundësia për të krijuar vatra infeksioni dhe sëmundjesh të migrantët që mbërrijnë pas udhëtime të gjata në qendër, është më e lartë.

Në zbatim të protokollit shëndetësor për parandalimin e COVID-19, në qendrën e Kapshticës ishin instaluar pajisje të dedikuara për larjen e duarve, si dhe ishin vendosur tabela informative dixhitale specifikisht me informacione mbi masat anti COVID-19, në gjuhë të huaja në dispozicion për migrantët gjatë qëndrimit në mjediset e Qendrës. Ky ishte një investim i kryer nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), në kuadër të projektit “Trajtimi i Sfidave të Covid -19, për Migrantët dhe Refugjatet në Ballkanin Perëndimor”, i financuar nga Bashkimi Evropian.

Nga inspektimi i kryer në Stacionin e policisë së kufirit në Kapshticë, si dhe nga monitorimi i vazhdueshëm që institucioni i Avokatit të Popullit kryen në terren nëpërmjet ekspertit të jashtëm në pikën kufitare të Kapshticës që prej vitit 2019, si rezultat i marrëveshjes mes Avokatit të Popullit dhe UNHCR-së, konstatohet se dhe në këtë Qendër, **stafet mbështetëse dhe investimet në Qendrat e pritjes së migrantëve të parregullt, janë kryer nga donatorë dhe partnerë të ndryshëm ndërkombëtarë dhe asnjë prej tyre nuk është kryer me fondet e buxhetit të shtetit shqiptar.**

Pavarësisht kushteve të krijuara, vëmendja e institucionit të Avokatit të Popullit është dhe do të jetë në vijësi e fokusuar ndaj respektimit të të drejtave të migrantëve të parregullt, që hyjnë në territorin shqiptar, sipas dispozitave ligjore në fuqi, por dhe konventave ndërkombëtare të lartpërmendura, që Shqipëria aderon dhe ka ratifikuar në këtë fushë.

Ambientet e intervistimit, ndihma juridike dhe psikologjike

Të gjithë migrantët e parregullt, pasi konstatohen nga rojet kufitare i nënshtrohen një procedure trajtimi, të përafuar me ato të vendeve të BE-së. Procedura është e bazuar në Udhëzimin e Ministrisë të Brendshme nr.293, datë 04.06.2015 *“Mbi trajtimin e të huajve me qëndrim të parregullt në RSH”* dhe në procedurën standarde *“Për përzgjedhjen e të huajve të parregullt”*, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë nr.172, datë 08.02.2018.

Punonjësit e policisë kufitare të Drejtorisë Rajonale të Kufirit Korçë, kryejnë procedurën e përzgjedhjes (screening proces) të flukseve migratore në mjedisin e intervistimit që ndodhet në Qendrën e pritjes së Migrantëve në Kapshticë. Nisur nga procedura që zhvillohet për përzgjedhjen e migrantëve, ata kategorizohen me statusin si më poshtë:

Azilkërkues - Kjo kategori dërgohet në Qendrën Kombëtare të Azilkërkuesve në Babrru. Gjatë vitit 2021, sikurse e referuam edhe më lart numri i personave të referuar për azil nga kjo Qendër u ul ndjeshëm.

Viktimë trafikimi apo viktimë e mundshme trafikimi - Kjo kategori i referohet menjëherë strukturave antitrafik të Policisë së Qarkut Korçë. Gjatë vitit 2021 nuk ishte evidentuar në territorin e Korçës ndonjë rast i tillë.

Imigrant i parregullt –në rastet kur nga procedura e përzgjedhjes dhe intervistimit të migrantëve, konstatohet se qëllimi i tyre është kalimi i tyre për në një nga vendet e BE-së, ndaj tyre merret urdhër largimi apo dëbimi nga territori i RSH, ndërsa në raste të shkeljeve ligjore ata ndalohen në Qendrën e Mbyllur për të Huajit në Karreç, Durrës.

Fëmijë të pashoqëruar - Kjo kategori identifikohet dhe intervistohet në prani të punonjësit të Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijës së Bashkisë Devoll dhe Korçë, që përfshin territorin ku është identifikuar fëmija i pashoqëruar. Të gjitha rastet janë trajtuar dhe ndjekur në bashkëpunim me Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve kryesisht pranë Bashkisë

Korçë, ndërkohë që familjet, gratë apo fëmijët e tyre kanë qëndruar në Qendrën Sociale të bashkive respektive, deri në kryerjen e procedurave. Trajtimi i rasteve është bërë sipas VKM nr.111, datë 06.03.2019 “Për procedurat e riatdhesimit të fëmijës”.

Sa i takon mjediseve të perzgjedhjes, ambienti i krijuar në Qendrën e pritjes së migrantëve në Kapshticë, i plotëson kushtet për kryerjen nga punonjësi i policisë së kufirit të procedurave për identifikimin, intervistimin dhe perzgjedhjen e migrantëve.

Në kushtet e emergjencës së pandemisë për parandalimin e COVID 19, këto mjedise është e nevojshme të rikonceptohen si shërbim me sportele mbrojtëse për shëndetin e migrantëve, si dhe të punonjësve të policisë kufitare, pasi janë në kontakt të vazhdueshëm gjatë gjithë kohës së intervistimit.

Vlen të theksojmë se, në të dyja Qendrat e pritjes së migrantëve në GOS Kakavijë dhe Grehot, ishin të pranishëm dhe asistonin me ndihmesën e tyre punonjësit e policisë kufitare gjatë intervistave që ata zhvillonin me migrantët, edhe ekspertët e FRONTEX-it.

Në procedurën e perzgjedhjes krahas punonjësve të policisë të kufirit, migrantët asistohen dhe nga përkthyesit, të cilët sigurohen nga CARITAS. Por, nga intervistat e zhvilluara me punonjësit e policisë kufitare, është problematikë se për disa gjuhë specifike si Dari, Fars, etj., nuk ka përkthyes të licencuar, çka e vështirëson komunikimin mes tyre gjatë procedurës së perzgjedhjes. Sipas tyre, në këto raste komunikimi bëhet në gjuhën angleze, aq sa mund të jetë e mundur ose në një gjuhë të përafërt me gjuhën e tyre.

Në përfundim, theksojmë gjithashtu se edhe Avokati i Popullit nëpërmjet ekspertëve të saj, vijon të asistojë grupet e përbashkëta të policisë kufitare dhe të FRONTEX, gjatë pritjes, intervistimit dhe procedurave të perzgjedhjes të migrantëve të parregullt, në zbatimin e standardeve më të mira që garantojnë respektimin e të drejtave të tyre, sipas dispozitave ligjore dhe akteve ndërkombëtare të përmendura më lart.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe, në bazë të nenit 81 pika 1 dhe 2/b të ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ku parashikohet midis të tjerash se: “1. Mekanizmi kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim mekanizmi kombëtar, i krijuar në përputhje me legjislacionin për Avokatin e Popullit, mbikëqyr zbatimin e këtij ligji për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve.

2. Në funksion të zbatimit të këtij ligji, mekanizmi kombëtar ushtron këto kompetenca: b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe

kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues”;

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme për nxitjen e procesit të draftimit dhe miratimit sa më parë të akteve nënligjore, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin “Për të Huajt” dhe ligjin “Për Azilin në RSH”.
2. Organizimin e trajnimeve të vazhdueshme të punonjësve të policisë kufitare, për njohjen me ndryshimet e reja ligjore dhe ngritjen e kapaciteteve të tyre të specializuara specifike, për kryerjen e procedurave të intervistave dhe të përzgjedhjes të migrantëve të parregullt, në pikat e kalimit të kufirit ku janë evidente flukset migratore.
3. Sigurimin në mjediset e intervistimit të përkthyesve, kryesisht për gjuhët Dari, Fars, etj., si dhe zhvillimin e përpjekjeve nga policia kufitare për ngritjen e një sistemi të qëndrueshëm të përkthyesve, sipas listës të miratuar nga Ministria e Drejtësisë.
4. Marrjen e masave të menjëhershme në bashkëpunim me Bashkinë Ersekë, për vënien në funksionim të plotë të Qendrës për sistemimin dhe akomodimin e fëmijëve të pashoqëruar, duke përcaktuar buxhete për investime në këtë qendër, si dhe për rritjen e stafit me psikologë dhe punonjës social për trajtimin e tyre.
5. Realizimi i një marrëveshje bashkëpunimi me palën e policisë kufitare greke, për kryerjen e protokollit të rregullt ligjor të kthimit pas të të huajve të parregullt që kanë hyrë nga territori grek, në rastet kur ata janë përsëritës apo atyre nuk u miratohet statusi i azilkëkruesit nga autoritetet shqiptare të përcaktuara në ligj.
6. Përmirësimin e masave të transportit të migrantëve të parregullt gjatë udhëtimit nën shoqërimin e policisë kufitare, duke respektuar masat e parashikuara në protokollet e mbrojtjes nga COVID-19.
7. Mbulimin me staf për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes, pastrimit dhe dizifektimeve periodike të Qendrës së përkohshme të migrantëve në Kapshticë.
8. Marrjen e masave për kryerjen e testeve të shpejta PCR të migrantëve të parregullt, përmirësimin e kushteve të qëndrimit në mjedisin e përzgjedhjes, duke marrë parasysh situatën aktuale mbi masat anti-COVID, me qëllim ruatjen e sigurisë së jetës dhe shëndetit të të huajve të parregullt dhe personelit të policisë kufitare.
9. Marrjen e masave për krijimin e tendave mbrojtëse në mjediset e jashtme në Qendrën e Kapshticës, kryesisht për stinën e verës për të lehtësuar qëndrimin e emigrantëve edhe në ambientet e jashtme të qendrës.

10. Marrjen e masave në bashkëpunim me Bashkinë Devoll për menaxhimin sa më mirë dhe disiplinimin e mbetjeve urbane, pasi ato hidhen në mjedise të pakontrolluara dhe nuk tërhiqen nga makinat e pastrimit.
11. Marrjen e masave për plotësimin e vendeve vakante me punonjës policie, sipas strukturës organike të miratuar për DVKM Korçë.
12. Të merren masa nga Ministria e Brendshme dhe Departamenti për Kufirin dhe Migracionin në DPSH, duke bashkërenduar punën midis autoriteteve përgjegjëse të përfshira në procesin e mbrojtjes, siç është Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, për të garantuar funksionimin e sistemit të integruar të mbrojtjes për fëmijët e pashoqëruar brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në Vendimin nr.111, datë 6.3.2019 *“Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijës”*.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

Ermonela XHAFJA